

## STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT

FAMILY HEALTH sh.p.k

Sot ,me date **24. 09. 2024** (dymije e njëzetë e katër) ne Tirane, unë Rubin Gjeta, shtetas shqiptar, lindur 09.05.1990 ne Librazhd me nr. Personal J00509069W , me zotësi të plotë për të vepruar, në bazë të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Pwr tregtarwt dhe shoqwritw tregtare" vendos të themeloj shoqërinë si mw poshtw

### KAPITULLI I

#### EMRI I SHOQËRISË- SELIA- KOHËZGJATJA-OBJEKTI

Neni 1

Emri

- Shoqëria do të quhet **FAMILY HEALTH shpk** . (Këtu e më poshtë "Shoqëria")
- Shoqëria do të organizohet në formën e një shoqërie me përgjësi të kufizuar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.
- Shoqëria ka logon dhe vulën e saj zyrtare.

Neni 2

Selia

2.1. Selia e shoqërisë do të jetë tek rr. BLV. BAJRAM CURRI; Nd. 2; H. 17; Ap. 10; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e palimituar.

Neni 4



## **Objekti**

### **4.1. Objekti i aktivitetit të shoqërisë është:**

Sherbime mjekesore, sherbim konsulencë mjekesore, performim i analizave gjenetike, mikrobiologjike, biokimike etj, ushtrim i aktivitetit diagnostikues dhe kurues ne kushte laboratorike, sherbime te tjera ne lidhje me sektorin e shendetesise ne te gjitha nivelet e sherbimit. Tregimi i pajisjeve mjekesore, import- eksport. Veprimtari sherbimi ne mbeshtetje te bizneseve te tjera. Ka te drejte te kryeje transaksione dhe operacione te tregtise se jashtme brenda veprimtarive te regjistruarra.

## **KAPITULLI II**

### **KAPITALI THEMELTAR**

#### **NENI 5**

#### **Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 lekë (njwqind lekë) i përbërë nga njw kuotw.

Z. Rubin Gjeta zotëron 100 % te kapital te shoqërisë ne vleren 100 lekë (njwqind lekë).

Kapitali mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te asamblese se ortakeve themelues. Kuota e Pjesmarresve ne kapital jane te gjitha te emruara dhe te pa ndashme. Kapitali eshte teresish i shlyeshem dhe i nenshkrueshem. Cdo kuote i takon e drejta e nje vote.

#### **NENI 6**

Ortaku qe ka ndermend te shesi kuotat e tij teresisht, apo pjeserisht duhet me pare te njoftoje ortakun tjeter te shoqerise. Ortaku tjeter ka te drejten e blerjes se pare. Kete te drejta ortaku duhet ta ushtroje Brenda 30 Diteve nga dita e njoftimit.

Ne rastin e mos ushtrimit te se drejtes se blerjes se pare, ortaku qe do te shese kuotat duhet te njoftoje emerin e bleresit dhe kushtet, te cilat nuk duhet te jene me te favorshme se sa ato te afuara ortaku tjeter te shoqerise.


#### **NENI 7**

Kapitali i shoqërisë përbehet, nga kapitali fillestar plus shtesën e bere, mjetet e xhiros, pasuri te luajtshme ose te paluajtshme etj te nevojshme për ushtrimin e aktivitetit te shoqërisë.

#### **NENI 8**

Kuotat e kapitalit janë te pasqyruara dhe te regjistruara ne librat e llogarisë te shoqërisë.

#### **NENI 9**



Heqja dore e ortakut nga bashkëpunimi nuk e çliron ortakun e larguar nga detyrimet qe kane lindur para se ai te largohet. Po kështu ai fiton dhe te drejtat qe janë krijuar para largimit te tij .

#### **NENI 10**

Fitimet qe realizohen gjate veprimtarisë dhe qe konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakeve ne proporcion me përqindjen e kapitalit te investuar, por kurdoherë pasi të jenë shlyer detyrimet ligjore.

Kapitali i investuar nga ortaket nuk mund te zvogëlohet nen kufijtë e parashikuar ne ligj .

#### **NENI 11**

Shoqëria tregtare “FAMILY HEALTH” sh.p.k. është përdoruese dhe disponuese e pasurisë se saj. Ajo mund te blejë dhe te shfrytëzoje te drejta te tjera, material ose jo material, duke përfshire edhe te drejtën për shitjen e pasurive se vet tek te tjerët.

Ne Republikën e Shqipërisë Shoqëria tregtare FAMILY HEALTH sh.p.k. gezon te drejta sikundër çdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj ne përputhje me legjislacioni ne fuqi.

#### **NENI 12**

Shoqëria tregtare “FAMILY HEALTH” sh.p.k. vepron ne regjimin e pronës private dhe merr përsipër te drejtat e detyrimet vetëm brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaket themelues te shoqërisë, mbartin rrezikun e veprimtarisë se shoqërisë, vetëm ne nivelin e kuotave te kapitalit te investuar ne te. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet qe ortaku kane pasur para se ajo te krijohet.

### **KAPITULLI I III**

#### **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

#### **NENI 13**

##### **Kompetencat e ortakut**

**13.1** Ka të drejtë të administroj aktivitetin e shoqërisë, konform objektit të veprimtarisë se saj, duke përfshire edhe veprimtarinë prodhuese e tregtuese që Shoqëria mund te kryej, vlerat e saj intelektuale e ekonomike-financiare. Kane të drejtë të marrin dijeni për rezultatet ekonomiko financiare ne çdo fazë te aktivitetit te saj. Kane te drejte te marrin pjese vete ose me ane te përfaqësueseve ne ketë aktivitet.

**13.2** Kane te drejte te tërheqin te gjitha dokumentet kryesore te shoqerise per tre vjetet e fundit

**13.3** Kane te drejte te heqin dore nga shoqeria dhe mund te shesin pjesen e kapitalit te tyre ne perputhje me kushtet qe i lejon statute dhe ligji.

**13.4** Ortaket ne perputhje me statutin e aktin e themelimit dhe legjislacionin ne fuqi kane, te drejte qe ne te njenjten kohe te jene ortake edhe ne shoqeri te tjera.

**13.5** Ortaket rezervojne te gjitha te drejtat sipas ligjit Tregtar.

#### **NENI 14**

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj z. *Rubin Gjeta*

#### **NENI 15**

##### **Administrimi i shoqërisë**

**15.1** Administratori ka te gjitha te drejtat dhe fuqite per drejtimin e zakonshëm te shoqërisë, me qellim qe te arrije objektivat e saj, përveç atyre qe ligji ia atribuon ortakeve.

15.2 Administratori përfaqëson shoqërinë ne mardhenie me te tretet si dhe para organeve te administratës dhe atyre gjyqjesore.

**15.3.** Administratori përgjigjet individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, për shkelje te statutit apo per deme te kryera gjate administrimit.Ortaku ka te drejte te ngrej padi ndaj administratorit.

**15.4** Administratori emerohet dhe shkarkohen me vendim te ortakut, kan të drejtë të veproj, firmosi pranë çdo organi administrativ, banke të nivelit të dytë dhe ku të shikohet e arsyeshme për të ushtruar aktivitetin e shoqërisë.

**15.5** Shoqeria administratohet te pakten 1(nje) dhe maksimumi 3(tre) administrator , te cilet qendrojnë ne detyre deri ne revokimin apo doreheqjen per nje periudhe maksimale prej (5 vjetesh

**15.6.** Çdo administrator do te ketë te drejte për rimbusimin e shpenzimeve te bera prej tij per llogari te shoqërisë .

15.7 Kur administrator i shoqerise rezulton i sukseshem ne punen e tij dhe ne rezultatin financier te kompanise atehere ortaket vendosin lidhur me shperblimin qe do ti jepet atij ne fund te vitit financier .

#### **NENI 16**

##### **Detyrat e Administratorit/ ëve**

Administratori i shoqërisë ka dhe këto detyra dhe te drejta.



- Te mirë administroje pasurine e shoqerise
- Te lidhe marveshje me te tretet Brenda objektit te veprimtarise se shoqerise dhe kompetencave te caktuara nga ortaket.
- Te zbatuje rregullat e brendeshme te shoqerise
- Te shperbleje demet qe I vijne shoqerise si pasoje e veprimeve apo mos veprimeve te tij.
- Te paguhet per punen e kryer ne baze te marveshjes se bere midis tij dhe ortakeve.
- Te marre te dhena e te beje propozime mbi gjithcka qe ai e quant e dobishme per shoqerine
- Te mirtaoje planet e llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre dhe ti paraqese ato sipas rastit per miratimin perfundimtar nga ortaket
- Te behen propozimet perkatese ortakut te vetem kur lind nevoja per ndryshime ne kapitalin themeltar te shoqerise.
- Te mirtaoje aktet normative qe percaktojne aportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire kuadrin e personelin
- Te percaktoje strukturen e aparatit te shoqerise dhe te krijojne organe te tjera te domozdoshme per realizimin e objektivave te shoqerise.
- Ti propozoje ortakeve per krijimin e enjesive strukturave te ndryhsme si filial, dege e e përfaqësi ne qytetet te tjera te vendit ose jashtë shtetit.
- Te përgatitese propozimin për pushimin e veprimtarisë se shoqërise dhe t'ia paraqesë ortakut për miratim.Të përzgjedhë ekspertin kontabël dhe anëtare te komisionit te likuidimit si dhe te paraqes propozimet për miratim para ortakeve .
- Te siguroje zbatimin e përpikte te Vendimeve te Ortakeve.
- Te kryeje çdo detyre tjetër qe i ngarkohet nga ortaku i vetem i shoqerise.

## NENI 17

### EKSPERTI KONTABEL

**17.1** Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo viti finanziar. Caktimi i tyre e bënë administrator

**17.2** Eksperti kontabël mban përgjegjësi per mirëmbajtjen e rregullt të gjithë dokumentacionit te shoqërisë



**17.3** Ato përgjigjen për demet qe i vijnë shoqërisë nga mbajtja e pa rregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

**17.4** Eksperti kontabël i autorizuar mund te shkarkohet sipas mënyrës se parashikuar nga legjislacioni ne fuqi .

**17.5** Nuk mund te ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesit, administratoret, personat qe jane ne gjini e kruhqit deri ne shkallen e katert. Po ashtu nuk mund te kryeje kete detyre pergjegjsat e syrave, filialeve e agjensive.

### **KREU III**

#### **MARDHENIET E PUNES**

##### **NENI 18**

Marrëdhëniet e punës ne shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratave te punës.Për çeshtjet qe kjo kontrate nuk I parashikon zbatohen dispozitat përkatëse te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

##### **NENI 19**

Për çdo mos marrëveshje qe mund te lind midis palëve dhe qe nuk zgjidhet me mirëkuptim apo konsensus, organi kompetent për zgjidhjen e saj është Gjykata e rrethit Gjyqësor Tirane.

##### **NENI 20**

##### **Sekreti i punës**

Te gjithë të punësuarit ne shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë Kjo detyre vazhdon edhe pas largimit te tyre nga shoqëria.

### **KAPITULLI I IV**

#### **VITIT FINANCIAR, BILANCI VJETOR SHPERNDARJA E FITIMIT**

##### **NENI 21**

##### **Viti finanziar**



Vitit finansiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

Përjashtimisht Viti I pare finansiar përfshin kohen nga data e regjistrimit te shoqërisë ne regjistrin tregtar dhe përfundon me 31 dhjetor te te nje viti.

## NENI 22

### Inventari dhe llogarite vjetore.

Shoqëria do te mbaje një kontabilitet te rregullt te pasurisë dhe te veprimtarisë se saj ne pajtim me kërkesat ligjore

Ne mbylljen e vitit finansiar administrator harton inventarin e pasurisë ne ketë date dhe llogarite vjetore për vitin finansiar .

## NENI 23

### Raportet vjetore

**23.1** Ne mbylljen e çdo viti finansiar administratori dhe eksperti kontabël harton inventarët dhe llogarite vjetore ne përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi për kontabilitetin si dhe harton një raport me shkrim për ortaket.

**23.2** Raporti pasqyron gjendjen e shoqërisë gjate vitit finansiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e rëndësishme etj.

**23.3** Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël te autorizuar(nëse është emëruar)miratohen nga ortaket sipas Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

## NENI 24.

### Rezerva e domosdoshme dhe e nevojshme.

**24.1** Nga fitimi i realizuar gjate vitit finansiar pasi zbriten humbet e vitit te mëparshëm, hiqet men je ane një shume e barabarte me 5 %(pese perqind) e fitimit e destinuar për formimin e fondit rezerve te quajtur "rezerve e domosdoshme ".

**24.2** Heqja nga fitimi për rezervën e domosdoshme pushon se qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin 10 % te kapitalit themeltar.Ajo rifillon kur për një arsyesh qfarëdo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nen 10% e kapitalit.



**24.3** Ortaket mund te vendosin edhe zbritje te veçante ne favor te rezervave te jashtëzakonshme ose për qëllime te tjera apo për shtyrjen e shpërndarjes se fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare te ardhshme.

#### **NENI 25**

Te ardhurat eventualisht te ndjekura nga shoqëria çdo vit finanziar janë te destinuara siç është vendosur nga ortaket duke i qëndruar ne uljen 5 % qe do ti destinohet rezervës ligjore.

### **KAPITULLI V**

#### **MBYLLJA E SHOQERISE, LIKUJDIMI**

#### **NENI 26**

Veprimtaria e shoqërisë mund te ndërpritet para afatit kur shoqëria nuk rezulton rentable gjate dy vjetëve te fundit radhazi dhe kur për ketë vendos gjykata kompetente.

#### **NENI 27**

**27.1** Menjëherë pas marrjes se vendimit për prishjen e shoqërisë, ortaket caktojnë një likuiditor, kompetencat e tij dhe mënyrën e likuidimit te shoqërisë, me dispozitat përkatëse te ligjit tregtar. Shoqëria gjate likuidimit mban anash emërtimit dhe emrin "Shoqëri ne Likuidim e siper".

**27.2** Likuiditori i emëruar nga ortaket menjëherë sa po merr detyrën është i detyruar te publikoje bilancin e shoqërisë duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe t'ia vene ne dispozicion menjëherë ortakeve.

**27.3** Me miratimin e likuidimit shoqëria i jep fund veprimtarisë.

#### **NENI 28**

Ortaket vendosin mbi rregulshmerine e likuidimit, per te vendosur per bilancin e likuidimit dhe heqjen e mandatit te likuiditorit.

Ortaket mund te vendosin vete realizimin e kesaj mbledhje, ne rast se likuiditori nuk e kerkon. Mbledhja vendoset edhe nga gjykata mbi propozimin e Ortakeve ose te nje mandatmbajtesi te caktuar prej tij.



## **NENI 29**

Kur ortaket për shkaqe te arsyeshme nuk vendosin për aktet e mësipërme, likuidatori dhe çdo person i interesuar mund te kërkoje nga Gjykata mbylljen e likuidimit.

Aktet e mbylljes dhe likuidimit e depozitimit te dokumentacionit ne regjistrin tregtar Shoqeriac' regjistrohet prej tij.

## **DISPOZITET KALIMTARE**

### **NENI 30**

#### **Dispozitat e fundit**

**30.1** Për te gjitha ceshtjet qe nuk gjejnë rregullim ne kete Statut, aplikohen dispozita e Ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

**30.2** Per efekt te inteprentimit te ketij Statuti me Ligj Tregtar nenkuptohet Ligji nr 9901 date 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregtare"

**30.3** Pavlefshmëria eventuale te dispozitave te veçanta te Statutit nuk mund te cenojnë vlefshmërinë e tij.

### **NENI 31**

#### **Gjykata kompetente.**

Gjykata kompetente per zgjidhjen e te gjitha mosmarveshjeve dhe intepretimin e Statutit te Shoqërisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

### **NENI 32**

#### **Hyrja ne fuqi**

Ky Statut dhe Akt themelimi hyn ne fuqi dhe eshte i detyrueshem per zbatim ne momentin e firmosjes nga Ortaket.

## **ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE**

**" FAMILY HEALTH " sh.p.k.**

Z.Rubin Gjeta

